



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 4168 prot.

Shkodër me, 26 / 11 / 2019

RELACION

Mbledhja e Senatit Akademik e datës 22.11.2019.

Në mbledhjen e Senatit Akademik (SA) të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" të datës 22.11.2019, u trajtuan dhe u morën vendimet përkatëse të mëposhtme:

- Në këtë mbledhje Senati u vu në dijeni për projektin "MARDS - Reformimi i studimeve doktorale në Mal të Zi dhe Shqipëri – paradigma e praktikës së mirë" si projekt i financuar nga Bashkimi Europian me titull me numër 598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP, me kohëzgjatje 15 nëntor 2018 - 15 nëntor 2021, në kuadrin e Marrëveshjes nr. 210 prot. datë 21.01.2019 që Universiteti i Shkodrës ka nënshkruar me koordinatoren e projektit MARDS – Universitetin e Malit. U vu në dukje rëndësia e këtij projekti për krijimin e Shkollës pilot, të qëndrueshme dhe moderne, të Doktoraturës me inute të përbashkëta të partnerëve të projektit në fushën "Ekonomia dhe turizmi për zhvillim të qëndrueshëm" në Fakultetin Ekonomik të Universitetit tonë. Për punën në këtë drejtim, u prezantuan në Senat aktivitetet kryesore të kryera gjatë periudhës 15 nëntor 2018 – 15 nëntor 2019 në kuadrin e këtij projekti. Senati shprehu gatishmërinë e tij për mbështetjen e hapjes së kësaj Shkolle Doktorale.
- Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 18/5, neni 23/1, neni 25/1, neni 25/7 neni 35/4, neni 35/9, neni 38/1/dh, neni 42/7, neni 74/3 pika b, VKM nr. 41, date 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", Statutit të USH 2018 neni 11/8 pika a, neni 17/6 pika g, neni 54 dhe me propozim të Fakultetit të Drejtësisë të USH-së, Senati Akademik me votim unanim miratoi riorganizimin e programit të studimit Bachelor në Juridik në "Program të integruar të studimit Master Shkencor në Juridik" me 300 kredite, sistemi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 5-vjeçare për vitin akademik 2020-2025. Ky vendim do t'i kalohet Bordit të Administrimit të USH për miratim përfundimtar dhe më pas dokumentacioni do t'i përcillet MARS. Gjithashtu Senati dakortësoi në parim idenë e hapjes së në Fakultetin Juridik "Programit të studimit Bachelor në Shërbime Publike" me 180 kredite, sistemi me